



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E HARTIMIT TË PROJEKTEVE, SHËRBIMEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr. \_\_\_\_ Prot

Patos më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023

**MIRATOHET**  
**KRYETARI**  
**Fation Duro**

**DETYRË PROJEKTIMI**

*Objekti:* **Rikonstrukcion i rrugës Lagjja e Re te Përroi Çam**

*Vendndodhja:* **Lagjja e Re, Bashkia Patos**

*Investitori:* **Bashkia Patos**

Gjendja e Objektivit

Objekti që kërkojmë të investojmë ndodhet në Lagjen e Re, në pjesën jug-perëndimore të qytetit të Patosit. Rruga është e shtruar me rërë bituminoze e cila në pjesën më të madhe të saj ka pësuar dëmtime me kalimin e viteve. Të dëmtuara janë gjithashtu edhe nënshtresat e kësaj rruge edhe krijimin e gropave të ndryshme sipërfaqësore të cilat në periudhën e rreshjeve krijojnë pellgje me ujë që sjellin agravimin e gjendjes së rrugës.

Për sa i përket kanalizimit të ujërave të bardha (ujërat e shiut) ato kanë munguar në këtë segment rrugor, po ashtu rruga nuk ka sipërfaqe trotuari në gjatësinë e saj.

Në këtë zonë kemi ndriçim pjesor.

Pothuajse në krahun e majtë të rrugës kemi të përqendruar banesat 1-2 katë. Këto banesa janë të rrethuara me mure më blloqe me themele betoni dhe butobetoni

Në krahun e djathtë të rrugës shtrihet përroi i cili kërkon ndërhyrje në pastrimin e bimësive në argjinaturë po ashtu dhe aluvioneve që kanë zënë shtratin e tij.

Rrjeti i kanalizimeve në këtë segment është pjesërisht i ndërtuar, por nga koha e gjatë e ndërtimit të tyre dhe nga ndërhyrjet e paligjshme në të është dëmtuar.

Qëllimi i Projektit

Qëllimi i projektit është përmisimi i infrastrukturës urbane në qytetin e Patosit. Si rrjedhojë do të realizohet rikonstrukcioni i kësaj rruge me të gjitha standartet e duhura sipas normave të projektimit. Ndërhyrja parashikon të përmirësojë si standartin e zonës ashtu dhe të lehtësojë qarkullimin për banorët e lagjes.

Objektivat:

1. Zgjerim i gjurmës së rrugës dhe realizimi sipas standarteve të elementëve të saj.
2. Ndërhyrje në kanalizimet dhe elementë të tjerë sipas projektit teknik, ku parashikohet realizimi i rrugës me gjerësi 4m së bashku me shtresat përkatëse.
3. Ndërtimi i trotuarëve për lëvizjen e qytetarëve me gjerësi 1.2 m sipas projektit dhe shtresat me trashësi përkatëse.
4. Sistemimi i ujërave të zeza dhe lidhja e tyre me kolektorët kryesore të shkarkimit.

Detyrat qe duhet te zgjidhe projekti

1. Heqja e shtresave ekzistuese të rërës bituminoze.
2. Trajtimi, pastrimi dhe sistemi i zonës, hapja e gjurmës së rrugës sipas projektit.
3. Realizimi i sistemit të kanalizimeve KUZ, KUB.
4. Realizimi i rrugës me elementët e saj sipas projektit me shtresat me trashësi përkatëse.
5. Realizimi i linjës së ndriçimit.
6. Ndërtimi i sinjalistikës horizontale dhe vertikale në rrugë.
7. Sistemimi i rugicave të lagjes me shtresat me trashësi përkatëse.
8. Preventivi të bëhet me çmimet manuale në fuqi dhe duke u shoqëruar me analizat për zërat e punimeve që nuk janë parashikuar në manualet e miratuara.

*Konceptoi:*

Ing. Boreta Murati

*Drejtori:*

Ing. Arben Manoku